



Nova Demokratska Stranka (NDS)

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

Zgjedhjet e Lokale në Republikën e Kosovës
16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.. .. .	3-5
Pasqyra e Pozitës Financiare.....6	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....7	7
Informacionet e përgjithshme	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....9-13	9-13

Raport i Auditorëve të Pavarur

Drejtuar Kryesisë të SP “Nova Demokratska Stranka –NDS”

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Mohuar

Ne kemi audituar raportet financiare të fushatës për zgjedhjet lokale të bashkëngjitura të Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “NDS”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 15 Tetor 2021, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqe 9-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të fushatës për zgjedhjet lokale të subjektit politik “Nova Demokratska Stranka”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme dhe të mjaftueshme të auditimit për të patur bazë për shprehje të një opinionit të auditimit.

Bazat për Mohim të Opinionit

- Ashtu siç është shpalosur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, zëri bilancor “Të hyrat buxhetore të fushatës për zgjedhjet lokale 15 Tetor 2021” e pasqyruar në vlerë prej 6,078.60 Euro dhe që kjo vlerë e pasqyruar nuk ka përputhshmëri me vlerën e të hyrave të fushatës e pasqyruar tek pasqyra e të ardhurave në raportin vjetor me 31.12.2021. Diferenca e të ardhurave të fushatës e pasqyruar në vlerë prej (7,247.11 Euro) më pak se sa vlera e shpenzimeve të pasqyruara nuk mund të dokumentohet dhe arsyetohet me besueshmëri. Ne mungesë të dokumentacionit mbështetës për vlerën e saktë të të hyrave buxhetore që i përkasin zgjedhjeve lokale 15 Tetor 2021, ne e kishim të pamundur të verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën e saktë të të hyrave të pasqyruara të periudhës raportuese.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 8 detyrimet ndaj furnitorëve , SP me 15 tetor 2021 ka prezantuar detyrimet ndaj furnitorëve në vlerë prej 2,978.13 Euro (bilanci në fillim 16 shtator 2021 vlera zero euro) . Ne mungesë të dokumentacionit mbështetës për vlerën e detyrimeve të prezantuara, ne e kishim të pamundur të verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën saktë të detyrimeve tjera të pasqyruara me 15 Tetor 2021.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 9 detyrimet tjera afatshkurta , SP NDS me 15 Tetor 2021 ka prezantuar detyrimet tjera afatshkurta në vlerë prej 7,247.12 Euro (bilanci në fillim 16 shtator 2021 vlera zero euro) . Ne mungesë të dokumentacionit mbështetës për vlerën e detyrimeve tjera afatshkurta të prezantuara, ne e kishim të pamundur të verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën saktë të detyrimeve të pasqyruara me 15 tetor 2021.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 të Pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve lidhur me pagesat e kryera tek vëzhguesit për fushatën vlera prej 6,090.00 Euro në emër

të kompenzimit të punës që e kanë kryer vëzhguesit për fushatën del se SP nuk ka përlogaritur dhe paguar tatimet dhe kontributet bazuar në kërkesat ligjore mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, Lgjit Nr. 05/L-028, neni 7 dhe 8 i ligjit.

- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 të Pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve subjekti politikë shpenzimet lidhur me aktivitetet dhe procedurat e praktikuara të blerjeve shpenzimi për reklama në gazeta dhe shtande, me të cilën ka pas një aktivitet furnizimesh ose marrje shërbimesh në vlerë prej 6,500.00 Euro. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës dhe specifikimin e shpenzimeve si dhe pranimin e materialeve dhe justifikimi i shpenzimit për vlerën e raportuar, ne e kishim të pamundur të verifikojmë ekzistencën, plotësinë dhe vlerën e saktë të shpenzimeve të ndodhura ashtu siç janë pasqyruar për periudhën raportuese.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tej opinionin tonë ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik NDS nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundur regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që SP të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Bilanci në fundë të periudhës	Bilanci në fillim të periudhës
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5		
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata			
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme	6		
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	2,978.13	8,741.90
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		2,978.13	8,741.90
Total pasuritë		2,978.13	8,741.90
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		(7,247.11)	8,741.90
Total Ekuiteti		(7,247.11)	8,741.90
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huat e pagueshme			
Të hyrat e shtyra			
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	2,978.13	0.00
Detyrimet Financiare afatshkurtra			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	7,247.11	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		10,225.24	0.00
Gjithsej detyrimet		10,225.24	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		2,978.13	8,741.90

Nova Demokratska Stranka-NDSPasqyrat Financiare e fushatës për zgjedhjet lokale
16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	16 shtator 2021 deri 15 tetor 2021
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		6,078.60
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00
Të hyrat tjera		
Gjithsej të hyrat për vitin		6,078.60
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet	2	6,340.00
Shpenzimet e transportit		
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	6,937.11
Blerja e mallrave	2	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	0.00
Shpenzimet e ndryshme	2	48.60
Gjithsej shpenzimet për vitin	2	13,325.71
Suficiti / (deficiti) për vitin		(7,247.11)

1. Informata të Përgjithshme

NOVA DEMOKRATSKA STRANKA-NDS

Udhëheqja: Elmija Regjepi (Kryetare e partisë)

Përfaqësues i autorizuar financiar – Naser Meta

Prezentuesi gjat Auditimit Almir Saiti

Selia e partisë: Rr. Qazim Berisha Nr.23 , Prizren.

Pasqyrat financiare të Nova Demokratska Stranka (më tutje “NDS”) janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 të ligjit nr. 04/L-212 Për të plotësuar dhe ndryshuar Ligjin nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, subjekti politik i regjistruar ka shqyrtuar mangësitë e konstatuara brenda pesë (5) ditëve të punës nga pranimi i draft raporteve të audituara, por nuk janë bërë korrigjime apo ndryshime në mënyrë që raporti përfundimtar dhe auditimi përfundimisht është përfunduar.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare në bankën PCB.

Shënimi 2: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	250.00	250.00	0.00
Pagesat e vëzhguesve	6,090.00	-	6,090.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera			
Gjithsej	6,340.00	250.00	6,090.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara			
Karburantet	0.00	-	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.			
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			
Çdo shpenzim tjetër i transportit			
Gjithsej shpenzimet e transportit	0.00	-	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Qiraja e lokalit të zyrës	380.00	280.00	100.00
Ushqimi	57.11	-	57.11
Aktivitete kulturore dhe rekreative			
Radio dhe spotet televizive	-	-	-
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	6,500.00	5,500.00	1,000.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	-	-	-
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	6,937.11	5,780.00	1,157.11
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	-	-	-
Pajisjet të vogla			
Gjithsej blerja e mallrave			
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	-	-	-
Telefoni, interneti dhe posta	-	-	-
Rryma, shërbimet komunale	-	-	-
Gjopa dhe ndeshkime			

Nova Demokratska Stranka

Shënimet për Pasqyrat Financiare të fushatës për zgjedhjet Lokale të Kuvendit Komunal

16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021

Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	//////////
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme			
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër			
Gjithsej shpenzimet e ndryshme			
Gjithsej shpenzimet	13,277.11	6,030.00	7,247.11

Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla						0.00

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					0.00

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

	Blerjet gjatë periudhës
Toka	
Objektet	
Veturat	
Pajisjet e zyrës	
Pajisjet e tekonojgjisë informative	
Pajisjet tjera	
Gjithsejtoka, objektet dhe pajisjet	////////////////////

Shënime tjera

Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme	Bilanci në fundë të periudhës Shumanë Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shumanë Euro
Gjithsej Llogarit e arkëtueshme	0.00	0.00

Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Bilanci në fundë të periudhës Shumanë Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shumanë Euro
Paraja në bankë	2,978.13	8,741.90
Paraja në arkë	-	-
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	2,978.13	8,741.90

Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	Bilanci në fundë të periudhës Shumanë Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shumanë Euro
..... furnitori 1	2,978.13	0.00
..... furnitori 2		
..... furnitori 3		
..... furnitori 4		
Llogaritë e pagueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	2,978.13	0.00

Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurta	Bilanci në fundë të periudhës Shumanë Euro	Bilanci në fillim të periudhës Shumanë Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	6,090.00	0.00
Detyrimet për qira	100.00	0.00
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	-	-
Detyrime tjera afatshkurtër	1,057.11	0.00
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	7,247.11	0.00

